

Graniti & Co SH.P.K.
Rruga, Zona Industriale p.n. Suharekë



**RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS PËR
FABRIKËN E PRODHIMIT E RRJETAVE PËR SUVATIM**

INVESTITORI: Graniti & Co SH.P.K.

Rruga, Zona Industriale p.n. Suharekë

Suharekë: Prill/2025

Marrëveshje Bashkëpunimi Për:

Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis Fabrikën e prodhimit te rrjetave per suvatim

Ndërmjet:

- 1. Graniti & Co SH.P.K. me adresë: Rruga, Zona Industriale p.n. Suharekë me numër Unik Biznesi: 811033555, e përfaqësuar nga Islam Balaj – pronar.**
- dhe**
- 2. Besim REXHEPAJ, lindur me 17.06.1964 me numër personal: 1030633152 nga Suhareka, person i licencuar për hartimin e Raporteve për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis me numër licence: 14/19/24.**

Besim Rexhepaj autorizohet për përgatitjen dhe dorëzimin e Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Impiantin e Prodhimit të Rrjetave për Suvatim, në përputhje me Ligjin me nr. 08/L- 181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe rregulloret në fuqi, në ngastrat kadastrale me nr: P-72116046 – 02785-15 dhe P-72116046- 02785-16, nr. i lëndës së Çertifikates 1844/2025, vendi i quajtur Shirokë në zonën industriale të Suharekës, Zona kadastrale Suhareke, komuna e Suharekës.

Graniti & Co SH.P.K

Islam Balaj

Nënshkrimi dhe Vula



Besim REXHEPAJ

I Licencuar për VNM, Nr. i Licencës: 14/19/24

Nënshkrimi

Suharekë: Prill/2025

CERTIFIKATAT E KOMPANISË INVESTUESE

	
Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo Qeveria - Vlada - Government Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - Ministarstvo Trgovine i Industrije Ministry of Trade and Industry	
	
AGJENCIA E REGJISTRIMIT TË BIZNESEVE NË KOSOVË KOSOVSKA AGENCIJA ZA REGISTRACIJE BIZNISA KOSOVA BUSINESS REGISTRATION AGENCY	
CERTIFIKATË E REGJISTRIMIT CERTIFIKAT O REGISTRACIJI CERTIFICATE OF REGISTRATION	
811033555	
Numri Unik Identifikues / Jedinstveni Matični Broj / Unique Identification Number	
Graniti & Co SH.P.K.	
Emri biznesit / Naziv biznisa / Name of business	
///	
Emri tregtar / Trgovačko ime / Commercial name	
Lloji biznesit: Poslovni tip: Business type:	Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara Društva sa ograničenom odgovornošću Limited Liabilities Companies
Adresa: Adresa: Address:	Zona Industriale Shirokë Suharekë
Data e regjistrimit: Datum registracije: Date of registration:	18/09/2012
22/05/2019 Data / Date / Datum	
	 Nënshkrimi / Signature / Potpis
Nr. ser. / Ser. br. / Ser. No.: 10029270	



AGJENSIONI I REGJISTRIMIT TË BIZNEVE NË KOSOVË
KOSOVSKA AGENCIJA ZA REGISTRACIJE BIZNISA
KOSOVA BUSINESS REGISTRATION AGENCY

Informata mbi biznesin
Information about business
Informacija o biznisu

Numri Unik Identifikues / Jedinstveni Matični Broj / Unique Identification Number
811033555

Aplikacioni / Application / Aplikacija

Subjekti i regjistrimit:
Registration subject:
Subjekt registracije:

Data e plotësimit:
Filling date: 18/09/2012
Datum:

Data e pranimit:
Reception date: 18/09/2012
Datum primljenje:

Numri i protokollit:
Protocol number: 24A0000083
Broj protokola:

Biznesi / Business/ Biznis

Tipi i biznesit
Business Type
Tip biznisa
Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara
Limited Liabilities Companies
Društvo sa ograničenom odgovornošću

Emri i biznesit:
Business name: Graniti & Co SH.P.K.
Naziv biznisa:

Emri tregtar:
Trgovačko ime: ///
Commercial name:

Adresa
Address
Adresa
Zona Industriale
Shirokë
Suharekë

Data e themelimit:
Date of establishment: 18/09/2012
Datum osnivanja:

Kapitali i përgjithshëm:
Total Capital: € 100,000.00
Totalni kapital:

Numri i punëtorëve:
Number of employees: 5
Broj radnika:



AGJENSIONI I REGJISTRIMIT TË BIZNEVE NË KOSOVË
KOSOVSKA AGENCIJA ZA REGISTRACIJE BIZNISA
KOSOVA BUSINESS REGISTRATION AGENCY

Informata mbi biznesin
Information about business
Informacija o biznisu

Numri Unik Identifikues / Jedinstveni Matični Broj / Unique Identification Number
811033555

Shënim me rëndësi / Important Note / Vazan podatak

; Numri mëparshëm i biznesit është NRB: 70881004 , me zbatimin e ligjit për numrin unik të identifikues të biznesit ka këtë numër NUI: 811033555

Informata plotësuese / Additional Information Note / Dodatna informacija



AGJENSIONI I REGJISTRIMIT TË BIZNEVE NË KOSOVË
KOSOVSKA AGENCIJA ZA REGISTRACIJE BIZNISA
KOSOVA BUSINESS REGISTRATION AGENCY

Informata mbi biznesin
Information about business
Informacija o biznisu

Numri Unik Identifikues / Jedinstveni Matični Broj / Unique Identification Number
811033555

Veprimtaritë / Activities / Delatnosti		
0811	Aktiviteti kryesor i biznesit	Nxjerrja e gurit dekorativ dhe të ndërtimit, gurit gëlqeror, gjipsit, shkurës dhe rrasave Quarrying of ornamental and building stone, limestone, gypsum, chalk and slate Vađenje ukrasnoga kamena i kamena za gradnju, vapnenca, gipsa, krede i škrljeva
4613	Aktivitetet tjera	Aktivitetet e ndërmjetësimit për shitjen e lëndës së drurit dhe materialeve të ndërtimit Agents involved in the sale of timber and building materials Posredovanje u trgovini drvom i građevinskim materijalom
2221	Aktivitetet tjera	Prodhimi i pllakëzave të plastikës, fletëzave, tubave dhe profileve Manufacture of plastic plates, sheets, tubes and profiles Proizvodnja ploča, listova, cijevi i profila od plastike
2223	Aktivitetet tjera	Prodhimi i artikujve të plastikës për ndërtimtarë Manufacture of builders' ware of plastic Proizvodnja proizvoda od plastike za građevinarstvo
2399	Aktivitetet tjera	Prodhimi i produkteve minerale jometalike p.k.t. Manufacture of other non-metallic mineral products n.e.c. Proizvodnja ostalih nemetalnih mineralnih proizvoda, d. n.
2391	Aktivitetet tjera	Prodhimi i produkteve gërryese Production of abrasive products Proizvodnja brusnih proizvoda
4941	Aktivitetet tjera	Transporti rrugor i mallrave Freight transport by road Drumski prevoz robe
2370	Aktivitetet tjera	Thyerja e gurit, formësimi dhe dhënia e formës përfundimtare Cutting, shaping and finishing of stone Rezanje, oblikovanje i obrada kamena
8292	Aktivitetet tjera	Aktivitetet e paketimit (ambalazhimit) Packaging activities Delatnosti pakiranja
2364	Aktivitetet tjera	Prodhimi i llaçeve Manufacture of mortars Proizvodnja gotove betonske smese
2362	Aktivitetet tjera	Prodhimi i produkteve prej llaçit për qëllime ndërtimi Manufacture of plaster products for construction purposes Proizvodnja proizvoda od gipsa za građevinarstvo
2369	Aktivitetet tjera	Prodhimi i artikujve të tjerë prej betonit, llaçit dhe çimentos Manufacture of other articles of concrete, plaster and cement Proizvodnja ostalih proizvoda od betona, cementa i gipsa
4676	Aktivitetet tjera	Tregtia me shumicë e produkteve të tjera të ndërmjetme Wholesale of other intermediate products Trgovina na veliko ostalim poluproizvodima



AGJENSIONI I REGJISTRIMIT TË BIZNEVE NË KOSOVË
KOSOVSKA AGENCIJA ZA REGISTRACIJE BIZNISA
KOSOVA BUSINESS REGISTRATION AGENCY

Informata mbi biznesin
Information about business
Informacija o biznisu

4799	Aktivitetet tjera	Tregtia tjetër me pakicë, jo në dyqane, tezga ose tregje Other retail sale not in stores, stalls or markets Ostala maloprodaja ne u prodavnicama, tezge ili pijace
4752	Aktivitetet tjera	Tregtia me pakicë e artikujve elektronikë, ngjyrave dhe xhamit, në dyqane të specializuara Retail sale of hardware, paints and glass in specialised stores Trgovina na malo željeznom robom, bojama i staklom u specijaliziranim prodavnicama

Filialet / Branches / Jedince

Bordi drejtorëve / Board of Directors / Upravni odbor

Emri: Name: Ime:	Islam Balaj
ID Personale: Personal ID: Licni ID:	1016361743
Pozita në biznes: Position in business: Pozicija u poslu:	Drejtore Ekzekutiv
Adresa: Address: Adresa:	Pn Tërrnjë Suharekë, Kosova

Pronarët / Owners / Vlasnici

Person fizik

Emri: Name: Ime:	Islam Balaj
ID Personale: Personal ID: Licni ID:	1016361743
Adresa: Address: Adresa:	Pn Tërrnjë Suharekë, Kosova
Përgjegjësia: Liability: Odgovornost:	
Pjesa në pronë: Owned part: Deo o vlasnistvu:	100,000.00€
Data lindjes: Birthdate: Datum rođenja:	



AGJENSIONI I REGJISTRIMIT TË BIZNEVE NË KOSOVË
KOSOVSKA AGENCIJA ZA REGISTRACIJE BIZNISA
KOSOVA BUSINESS REGISTRATION AGENCY

Informata mbi biznesin
Information about business
Informacija o biznisu

Personat e autorizuar / Authorized participants / Ovlascene lice

Emri: Name: Ime:	Kushtrim Balaj
ID Personale: Personal ID: Licni ID:	1172684200
Pozita e punës: Job position: Radno mesto:	Agjend i Regjistruar
Adresa: Address: Adresa:	Zona Industriale Shirokë Suharekë, Kosova
Autorizimet: Authorizations: Autorizacije:	

LICENCA E HARTUESIT TË RAPORTIT



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Zivotne Sredine Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment Spatial Planing and Infrstructure

Në bazë të nenit 12 të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr.08L/181 dhe Udhëzimi Administrativ për
Licencim të Hartuesëve të Raporteve për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr.10/2017, Ministri i MMPHI
lëshon:

Nr. i licencës: 14/19/24

LICENCË

Besim REXHEPAJ

Ms.i Gjeologjisë

Licencohet si person fizik për hartimin e raporteve të VNM-së

Data e vlefshmërisë:
12.08.2024— 11.08.2029
Prishtinë


Z. Liburn Aliu
Ministër i MMPHI

Përmbajtja

1.	HYRJE	14
2.	KUADRI LIGJOR PËR HARTIMIN E RAPORTIT	15
3.	METODOLOGJIA E PUNËS	16
4.	PËRSHKRIMI I LOKACIONIT DHE MJEDISIT	17
4.1	Pozita gjeografike e lokacionit.....	17
4.2	Popullata dhe vendbanimet	19
	Ndërsa impianti i për Prodhimin e Rrjetave për suvatim ndodhet në Zonen Industriale në Shirokë K. Suharekë me të kufirit të fshatit Shirokë, Reshtan dhe Suharekës.	20
	Ne afërsi të impianti janë një numër mjaftë i vogël i shtëpive, shih fig. E më poshtme Pronari i kompanisë “GRANITI & CO” SH.P.K. është zotuar që do të përmbahet të gjitha ligjeve që kanë të bëjnë me mbrojtjen e ambientit dhe do të jete i kujdesshme gjatë operimit që mos të i shqetësoj banorët në këtë lokalitet.	20
4.3	Lidhjet e komunikacionit dhe Distanca nga Shtëpitë	21
4.4	Kushtet klimatike	21
4.5	Lagështia e ajrit.....	22
4.6	Erërat.....	22
4.7	Karakteristikat hidrologjike.....	23
4.8	Natyra dhe biodiversiteti	24
4.9	Flora	25
4.10	Fauna.....	26
4.11	Peizashi.....	26
4.12	Ajri	26
5	PROCESIT TEKNOLOGJIK I PRODHIMIT TË RRJETAVE NGA FIRBA E XHAMI DHE PAJIMET	28
5.1	Objektet – pajimet e fabrikës	28
5.2	Linja e prodhimit të rrjetave plastike	36
5.3	Përshkrimi i procesit teknologjik.....	37
6	PËRSHKRIMI I ALTERNATIVAVE TË ARSYESHME	39
6.1	Zonat me industri të njëjta ekzistuese:	39
6.2	Sipërfaqet e fushave të gjelbërta:	39
6.3	Infrastruktura e transportit:.....	39
6.4	Ndikim mjedisor:.....	39
6.5	Zonimi dhe rregulloret:	39
6.6	Marrëdhëniet me komunitetin:	40
6.7	Shërbimet komunale dhe infrastruktura:	40
6.8	Kushtet gjeologjike dhe gjeoteknike:	40
6.9	Kërkesa e tregut:.....	40
6.10	Mbrojtje dhe siguri:	40
6.11	Potenciali i zgjerimit:	40
6.12	Logjistika dhe vendi i lokacionit:	40
6.13	Qëndrueshmëria mjedisore:.....	40
6.14	Afërsia me fuqinë punëtore:	40
6.15		
7	IDENTIFIKIMI DHE PËRSHKRIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS	41
7.1	Ndikimet në ajër.....	41

7.2	Ndikimet në tokë	42
7.3	Ndikimet në ujë	42
7.4	Ndikimet në peizazh, florë dhe faunë	43
7.5	Ndikimi në vendbanime dhe popullatë	43
7.6	Ndikimi nga zhurma	43
7.7	Ndikimet në raste të aksidenteve mjedisore	43
8	MASAT PËR ZVOGËLIMIN E NDIKIMEVE NË MJEDIS	44
8.1	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ajër	44
8.2	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në tokë	44
8.3	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ujë	45
8.4	Masat për mbrojtjen nga Zhurma	46
8.5	Masat për mbrojtje nga rreziqet dhe aksidentet	46
9	PROGRAMI I MONITORIMIT	46
10	RAPORTIMI	47
11	MASAT REHABILITUESE PAS PËRFUNDIMIT TË AKTIVITETIT	47
12	PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME	47
13	ANALIZA KOST – BENEFITE E PROJEKTIT NË FORMË TABELARE	50
14	LITERATURA E PERDORUR	51

Lista e tabelave

Tabela 1.	Koordinatat e objektit të fabrikes	19
Tabela 2.	Të dhënat elementare klimatike në zonën e interesit	22
Tabela 3.	Tabela e kostos	50

Lista e figurave

Figura 1.	Pozita Gjeografike e Komunës së Suharekës në Hartën e Republikës së Kosovës	17
Figura 2.	Harta e rrugëve dhe Lokacioni i Kompanisë nga Komuna e Suharekës	18
Figura 3.	Lokacioni i Kompanisë nga fshatrat perreth parcelave	20
Figura 4.	Distanca e lokacionit të kompanisë nga rrugët dhe shtepite e banimit	21
Figura 5.	Trëndafili i erës	23
Figura 6.	Distanca e Impiantit nga Lumi me i afert Lumi Toplluhë	24
Figura 7.	Skema teknologjike e linjës së prodhimit	36
Figura 8.	Linja e procesit teknologjik për prodhimin e rrjetave të plastike	37
Figura 9.	Produkti final rrjeta	38

1. HYRJE

Ky Raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis është punuar për Impiantin e prodhimit të rrjetave për suvatim, me investitor Graniti & Co SH.P.K. në ngastrat kadastrale me nr. në ngastrat kadastrale me nr: P-72116046 – 02785-15 dhe P-72116046- 02785-16, nr. i lendës së Çertifikates 1844/2025, vendi i quajtur Shirokë në zonën industriale të Suharekës, Zona kadastrale Suhareke, komuna e Suharekës, i cili është përgatitur duke u bazuar në legjislacionin mjedisor të Kosovës, veçanërisht sipas Ligjit nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.

Prodhimi i rrjetave plastike për suvatim është një pjesë e rëndësishme e sektorit të ndërtimtarisë në Kosovë dhe është zhvilluar paralelisht me kërkesat e këtij sektori.

Edhe pse si aktivitet, prodhimi i rrjetave për suvatim nuk përfshinë djegie të lëndëve fosile, ndërhyrje fizike të theksuara në mjedis apo shfrytëzim të resurseve ujore, megjithatë, si aktivitet është i pakontrolluar dhe herë pas herë mund të ketë ndikime në mjedis, prandaj edhe është subjekt i procedurave për Pëlqim Mjedisor.

Kompania Graniti & Co SH.P.K. ka iniciuar hartimin e raportit të VNM-së për të identifikuar ndikimet e mundshme në mjedis, me qëllim të ndërmarrjes së masave të nevojshme dhe zgjedhjen e alternativave për minimizimin e ndikimeve negative në mjedis.

Të dhënat për hartimin e raportit janë siguruar nga burime të ndryshme, literaturë ekzistuese, Plan i zhvillimor komunal i Suharekës, raportet e ndryshme mbi vlerësimin e aktiviteteve të ngjashme, dhe gjithashtu janë realizuar vizita në vendin ku është bërë ngritja e Impiantit për prodhimin e rrjetave plastike për suvatim me qëllim të njohjes me zonën, me pajimet, objektin, procesin teknologjik dhe infrastrukturën në lokacion.

Duke e pasur parasysh se sektori i prodhimit të materialeve ndërtimore në Kosovë, përfshirë ndërtimin e fabrikave për prodhime të materialeve ndërtimore (fasadave) është një nga sektorët me zhvillimin më të madh, si dhe duke e pasur parasysh kërkesën për materiale ndërtimore kompania Graniti & Co SH.P.K., ka ngritur impiantin për prodhimin e rrjetave plastike që përdoren si pjesë përbërëse e materialeve për izolime termike të objekteve.

Lokacioni i impiantit për prodhimin e rrjetave plastike për suvatim është i vendosur në njësinë e kadastrave me nr. P-72116046 – 02785-15 dhe P-72116046- 02785-16, nr. i lendës së Çertifikates 1844/2025, vendi i quajtur Shirokë në zonën industriale të Suharekës, Zona kadastrale Suhareke, komuna e Suharekës.

2. KUADRI LIGJOR PËR HARTIMIN E RAPORTIT

Duke marr në konsideratë karakteristikat e projektit, madhësinë e shtrirjes së tij, ndikimet e mundshme në mjedis si dhe vendndodhjen e impiantit si dhe duke u bazuar në legjislacionin mjedisor në fuqi ku parashihet që ky projekt është subjekt i vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe i përket shtojcës së dytë, nën-pika 5.8, e Ligjit nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.

Për përgatitjen e këtij raporti janë konsultuar ligje të tjera relevante, si

Ligjet:

- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025
- Ligji për mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja Nr. 08/L-0256
- Ligji për ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147
- Ligji për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174
- Ligji për Mbeturina Nr. 04/L-060
- Ligji për Mbrojtjen e Natyrës Nr. 03/L-233
- Ligji për Mbrojtje nga Zhurma Nr. 02/L-102
- Ligji për Ndërtim Nr. 04/L-110
- Ligji për mbrojtje nga Zjarri me nr, 04/L-012

Udhëzimet Administrative:

- Udhëzimi Administrativ MMPHI Nr. 02/2022 për Kushtet, Mënyrat, Parametrat dhe Vlerat Kufizuese të Shkarkimit të Ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në Trupin Ujorë.
- Udhëzimi Administrativ Nr. 13/2013 për Katalogun Shtetëror të Mbeturinave,
- Udhëzim Administrativ (QRK) nr. 07/2021 për rregullat dhe normat e shkarkimeve në ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes.

3. METODOLOGJIA E PUNËS

Për të vlerësuar ndikimin në mjedis si dhe për të identifikuar masat para parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimeve në mjedis, për impiantin për prodhimin e rrjetave plastike për suvatim, është ndjekur qasja e vlerësimit të përgjithshëm të projekteve të kësaj natyre, si dhe është bërë analiza dhe identifikimi i ndikimeve sipas fazave.

a. Informatat themelore mbi:

- Burimet themelore të ndikimeve në mjedis
- Popullatën dhe vendbanimet në lokacion
- Topografia dhe peizazhi në lokacionin e projektit
- Klima dhe të dhënat meteorologjike
- Kualiteti i ajrit ujit dhe komponentëve tjerë mjedisor në lokacion
- Bota bimore dhe shtazore në lokacionin e projektit

b. Vlerësimi i ndikimeve sipas kriterëve në vijim:

- Gjendja e mjedisit në lokacionin e projektit
- Lloji dhe madhësia e pritshme e ndotjes nga projekti
- Karakteristikat dhe përbërja e materialit ndotës
- Vlerësimi i përhapjes së ndotjes

c. Përcaktimi i masave për parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimeve në mjedis, duke u bazuar në rezultatet / të gjeturat nga vlerësimi i ndikimeve në mjedis, në lokacionin e projektit.

4. PËRSHKRIMI I LOKACIONIT DHE MJEDISIT

4.1 Pozita gjeografike e lokacionit

Komuna e Suharekës kufizohet me Komunat e Prizrenit, Rahovecit, Shtimes, Ferizaj, Shtërpçës, Malishevë dhe Mamushës.

Shtrihet në gjerësi gjeografike veriore prej $42^{\circ} 15'$ – Parkut Nacional “Sharri” (jugu), $42^{\circ} 30'$ – Malet e Berishes dhe Javori (veriu). Gjatësia gjeografike lindore : $20^{\circ} 45'$ - komuna e Rahovecit (perëndim), $21^{\circ} 00'$ - Malet e Jezercit, Guri i Dellocit (lindje). Komuna e Suharekës është e rrethuar me male të larta, në veri- perëndim me malet e Pagarushës dhe të Temeqinës me lartësi mbidetare prej 796 deri 828 m, në veri me ato të Carralevës 922 deri 1.048 m, në lindje me malet e Jezercit 1.677 m (Kryet e Ahishtës) dhe në jug-lindje me malet e Sharrit 2.092 m (Dera e Pashës) ndërsa në perëndim me rrafshinën (ultësirën) e Prizrenit. Lartësia mesatare mbidetare në komunë është 455 m. Vetë qyteti i Suharekës gjendet në lartësi mbidetare prej 400 m.



Figura 1. Pozita Gjeografike e Komunës së Suharekës në Hartën e Republikës së Kosovës

Ndersa kompania Graniti & Co SH.P.K. me lokacion në anën e djathtë të rrugës Magjistrale M25 që shpie nga Suhareka në Prizren, me largësi 1.6 Km nga kjo rrugë, 3.5 km nga qyteti i Suharekës.




Figura 2. Harta e rrugëve dhe Lokacioni i Kompanisë nga Komuna e Suharekës

Sipërfaqja ku është e ndërtuar impjanti për prodhimin e rrjetave për suvatim është një hapësirë me sipërfaqe të rrafshët, më herët kjo sipërfaqe nuk ka qenë e mbjellur por djerrinë, por në vitet e fundit për arsye të pozitës gjeografike, këto sipërfaqe dhe sipërfaqet tjera në rrethinë kanë qenë djerrin dhe për arsye se me vendim të Komunës Suharekë është shëndrruar në Zonë Industriale për shkak të pozitës gjeografike që ndodhet lokacioni, për arsye se afër lokacionit kalon rruga magjistrale që e lidh Suharekën me Prizrenin, autostraden dhe pjesën tjetër të Kosovës. Përgjatë rrugës magjistrale janë ndërtuar dhe janë duke u ndërtuar objekte afariste, siq janë pompa të derivateve, objekte tregtare dhe industriale, depo të materialeve ndërtimore etj. Në afërsi të ngastrave kadastrale ku është e ndërtuar impjanti për prodhimin e rrjetave dhe kënevë plastike dhe atë ne afërsi nuk ndodhen objekte të banimit por vetëm objekte afariste, siq janë objekte tregtare dhe industriale, depo të materialeve ndërtimore, ku shtëpitë më të afërta janë ato të Lagja Bajraktari ne Suharekë që janë mbi 200m largësi.

Më saktësisht lokacioni gjendet në koordinatat:

Tabela 1. Koordinatat e objektit të fabrikes

Nr	Y	X
1	7484092.26	4690050.81
2	7484012.13	4690044.56
3	7484029.49	4689946.08
4	7484036.46	4689946.08
5	7484041.45	4689947.02
6	7484109.62	4689952.33
7	7484173.30	4689957.30
8	7484177.79	4689957.65
9	7484189.75	4689958.58
10	7484172.39	4690057.06

4.2 Popullata dhe vendbanimet

Popullata, zhvillimet demografike, si dhe vendbanimet, paraqesin disa nga veçoritë kryesore të cilat duhet të konsiderohen në procesin e vlerësimit të ndikimit në mjedis. Kjo për shkak se afërsia e vendbanimeve, dhe popullatës, ndaj aktiviteteve janë ndër faktorët kryesor, të cilët i ekspozohen ndikimeve në mjedis.

Komunën e Suharekës, si njësi territoriale, e përbëjnë: qyteti i Suharekës, lagjet urbane dhe fshatrat. Territori i Komunës përfshinë Suharekën dhe këto vendbanime: Bllacë, Budakovë, Bukosh, Breshanc, Delloc, Dobërdelan, Dragaqinë, Dubravë, Duhël, Dvoran, Greikoc, Greiçec, Gelancë, Gjinoc, Javor, Kastërc, Krushicë e Epërme, Krushicë e Poshtme, Leshan, Luzhnicë, Maqitevë, Mohlan, Mushtisht, Nepërbisht, Nishor, Papaz, Peqan, Popolan, Qadrak, Reshtan, Reqan, Savrovë, Samadrexhë, Sallagrazhdë, Semetisht, Sllapuzhan, Sopijë, Stravuçinë, Studençan, Tërrnje, Vërshec dhe Vraniç.

Sipas të dhënave të fundit zyrtare të Agjencisë së Statistikave të Kosovës⁴ të vitit 2017, Komuna e Suharekës aktualisht ka 41 vendbanime, ku jetojnë 60,196 banorë. Bazuar në sipërfaqe aktuale prej 361.78 km², dendësia aktuale e banorëve është 165 banorë/km².

Ndërsa impianti i për Prodhimin e Rrjetave per suvatim ndodhet ne Zonen Industriale ne Shiroke K. Suhareke mes te kufirit te fshatit Shiroke, Reshtan dhe Suharekës.




Figura 3. Lokacioni i Kompanisë nga fshatrat perreth parcelave

Është me rëndësi të thuhet se projekti nuk parasheh zhvendosjen e ndonjë shtëpie banimi, dhe ndikimet e drejtpërdrejta në popullatë dhe vendbanim janë të përkohshme. Impianti për prodhimin e Rrjetave Plastike në pikëpamje mjedisore nuk pritet të ketë ndonjë ndikim të theksuar në popullatë (zhvendosje), ndërsa në anën tjetër, pritet të ketë efekte pozitive, në punësimin e tyre.

Ne afërsi të impianti janë një numër mjaftë i vogël i shtëpive, shih fig. E më poshtme Pronari i kompanisë “GRANITI & CO” SH.P.K. është zotuar që do të përmbahet të gjitha ligjeve që kanë të bëjnë me mbrojtjen e ambientit dhe do të jetë i kujdesshëm gjatë operimit që mos të i shqetësojë banoret në këtë lokalitet.

4.3 Lidhjet e komunikacionit dhe Distanca nga Shtepite

Lokacioni ka lidhje të mira komunikacioni si dhe infrastrukturë rrugore e cila e lehtëson transportin, si të lëndës së parë, po ashtu edhe të produkteve finale: Rrjetave Plastike të gatshme. Lokacioni gjendet pranë Autostradës Ibrahim Rugova (544m) dhe rrugës regjionale që lidh qytetet si: Prizrenin (965m), Rahovecin (700m). Impianti i prodhimit ka një distancë prej 220 metra nga shtëpitë më të afërta.



Figura 4. Distanca e lokacionit te kompanise nga rrugët dhe shtepite e banimit

4.4 Kushtet klimatike

Temperatura mesatare vjetore e ajrit në Suharekë është 11°C. Në muajin gusht lajmërohet maksimumi absolut prej 38,2°C. Amplituda absolute është 52,3°C. Komuna e Suharekës gjendet, në jug të Kosovës dhe ka klimë kontinentale me ndikim mesdhetar.

Në vijim janë radhitur vlerat kyçe klimatike:

- Vlerat mesatare relative vjetore e lagështisë në Suharekë është 74.3% .
- Lagështia më e ulët relative e ajrit në Suharekë është në muajin gusht 63.2%.
- Në Suharekë është vranësira më e vogël në muajin gushtë (2.7), ndërsa vranësira mesatare vjetore është 5.0 të dhjetat e qiellit.
- Vlera mesatare e të reshurave në Suharekë është 674.0 mm. Të reshurat më të mëdha

janë në muajin tetor ndërsa më të vogla në muajin shkurt dhe janar.

- Të reshurat më të mëdha në Suharekë janë gjatë muajit mars 169.6 mm, ndërsa sasia minimale e të reshurave në këtë territor është 410.0 mm.
- Në Suharekë më së shpeshti fyejnë erërat nga verilindja (193%), lindja (32%), dhe jugperëndimi(32%), ndërsa më së paku fyejnë erërat nga jugu (33%), dhe veri perëndimi (13%). Shpejtësinë, mesatare më të madhe e kanë erërat nga jugperëndimi (4.6m/sek) dhe verilindja (3.6m/ sek).

Tabela 2. Të dhënat elementare klimatike në zonën e interesit

	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	m.vjet.
Temp. max .	16.4	20	25.5	26.3	32.3	36.5	37	38.2	35	30.2	23.8	22	38.2
Temp. min.	-14.1	-12.4	-10.4	-3	1	7	6	6.2	1.5	-1.8	-9	-11	-14.1
Temp. mes.	0	1.7	5.3	11.5	15.7	19.8	22.7	22.3	18.2	11.7	7.2	3.3	11.6
Lagështia %	84.5	76.6	75.4	75.0	75.0	69.4	63.6	63.2	68.1	71.8	85.7	34.2	74.3
Shtypja atmosferë.	954.1	949.6	938.4	942.6	948.5	950.1	948.4	948.2	948.6	948.6	948.7	948.6	947.9
Shpj. e erës m/s	1.0	1.5	2.5	2.7	1.9	2.4	2.2	1.9	1.8	1.8	2.2	2.6	2.0
Reshjet - shi	33.0	12.0	26.0	47.0	89.0	124.0	36.0	37.0	31.0	136.0	70.0	33.0	674.0
Reshjet - borë	0.4	3.9	4.2	2.1	0.3	0.1	0.4	3.9	4.2	2.1	0.3	0.1	0.4

4.5 Lagështia e ajrit

Lagështia e ajrit është shumë e rëndësishme për turizmin, shëndetin dhe potencialet bujqësore. Për njeriun lagështia e pranueshme është 40%-70%, ndërsa lagështia mesatare e ajrit në Prizren është 70.4%. Vlerat më të larta të lagështisë vërehen në vjeshtë dhe dimër (75.1%) për shkak të rrymimit të ajrit nga deti Adriatik në dimër. Në verë lagështia është dukshëm me e ultë se 70 % (Tabela 1.4).

Precipitimi është po ashtu një nga komponentët e rëndësishme të strukturës klimatike dhe është esenciale për prodhimtarinë bujqësore të dihen periudhat e precipitimit. Në Prizren të reshurat janë më të larta në dimër.

4.6 Erërat

Element me rëndësi i klimës është edhe era. Nga drejtimi i fryerjes, dendurisë dhe fuqisë në shkallë të madhe varen dhe elementet e tjera të klimës.

Denduria e erërave është e shprehur në promil (%). Në tabelën e poshtme janë të shprehura vlerat e dendurisë (frekuencës) së erërave në 16 drejtimet si dhe qetësia e shprehur në promil. m/sec⁻¹.

Trëndafili i erës: 2020
Gjatësia gjeografike e st.: 20° 44' 08.41"

Lartësia mbidetare e st.: 402 m lmd
Gjerësia gjeografike e st.: 42° 14' 51.04"




Figura 5. Trëndafili i erës

4.7 Karakteristikat hidrologjike

Komuna e Suharekës ka rrjetë mjaft të zhvilluar hidrografike, gjegjësisht ka numër mjaft të madh të lumenjve (përroskave) që kalojnë në territorin e komunës. Lumenjtë e vegjël janë lumenj me tipare karakteristike për përroskat malore, që dmth lumenj të vegjël, me oscilime shumë të mëdha të sasisë së ujit gjatë vitit.

Gjatë kohës së thatë në shumicën e këtyre lumenjve ka shumë pak ujë ose nuk ka ujë fare, kurse gjatë kohës me reshje shpesh ndodh që të ketë vërshime lokale. Të gjithë ujërat burojnë dhe rrjedhin në territorin e komunës përpos disa përroskave si përroska e Cërrnalevës, Topillës dhe lumit të Bllacës që burimin e kanë në territorin e komunës së Suharekës, kurse pjesa më madhe e tyre dhe derdhja e ujërave të tyre bëhet në komuna tjera.

Lumi më i madh i komunës dhe arteria kryesore hidrografike është lumi Toplluha. Ky lum formohet nga përroskat lokale, dhe si degë më e madhe është lumi i Semetishtit. Toplluha është një ndër degët e majta të lumit, më të madh në Kosovë, Drini i Bardhë. Sipërfaqja e pellgut të Toplluhes është $F=510.0\text{km}^2$, kurse gjatësia e lumit është 15,5km. Toplluha kalon nëpër qytetin e Suharekës, kurse derdhja e tij në Dri bëhet afër fshatit Piranë komuna e Prizrenit. Mbi gjysma e sipërfaqes së pellgut janë toka punuese, rreth 30% livadhe dhe kullosa, 10% male dhe pjesa

tjerët është djerrinë.

Ndërsa sa i përket lokacionit ku është duke operuar fabrika e prodhimit të rrjetave, nuk ka ndonjë rrjedhe ujore që do të ndikonte në ndotjen e ujerave sepse nga procesi teknologjik i prodhimit të rrjetave nuk ka shkarkime të ujerave të ndotur.

Duhet cekur se, lumi më i afërt është Lumi Toplluhë me një distance 580.00 m shih fig 6.




Figura 6. Distanca e Impiantit nga Lumi me i afërt Lumi Toplluhë

4.8 Natyra dhe biodiversiteti

Komuna e Suharekës ndodhet në pjesën verilindore të luginës së Prizrenit, në kufijtë të shpateve të Prizrenit në një anë dhe e Podrimljes në anën tjetër. Lartësia mesatare mbidetare është 455m. Nëpër luginë të Drinit të Bardhë në klimë kontinentale kësaj ane ka ndikim klima e mesdhetare e cila mundëson kushte të mira për zhvillimin e vegjetacionit. Lumi kryesor i Suharekës është “Suhareka” e cila rrjedhë nëpër vendbanim të Suharekës. Ky lum në rrjedhën e tij të poshtme quhet Topllugë. Vetë emri i këtij lumi tregon se ky gjatë pjesës më të mëdha shtjerrat, ndërsa gjatë pjesës më të madhe të vitit në shtratin e tij ka mjaft sasira të vogla të ujit. Në kohën e të reshurave të mëdha lajmërohen valët vërshuese. Territori i rrjedhës së tij është i përfaqësuar mjaft mirë me erozion.

Sipas Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës, por edhe sipas observimeve në terren, në

lokacionin e projektit nuk ka zonë të mbrojtur, nuk ka lloje të mbrojtura, të rralla, apo endemike, dhe po ashtu nuk ka një potencial për vënie nën mbrojtje të zonës apo të ndonjë lloji, andaj ky impiant për prodhimin e rrjetave nuk do të sjell ndonjë problem në lokacionin ku është i vendosur.

4.9 Flora

Sipërfaqet bujqësore ekonomike janë sipërfaqe të punuara (23.378 ha). Bujqësia është dega kryesore e kësaj komune. Sipërfaqja e punuar, respektivisht arat dhe kopshtet (12.918 ha) shfrytëzohen kryesisht për prodhimin e grunajave (grurit, misrit, elbit dhe thekrës), të bimëve industriale dhe perimeve (lule diellit, grosha dhe patatja) dhe bimëve për kafshë (tërfoja dhe jonxha). Përmiset përfshijnë sipërfaqen prej 426 ha. Përmëtaria nuk është një degë aq e rëndësishme ekonomike. Në to kryesisht kultivohen kumbullat, mollët dhe qershizat. Suhareka ka kushte mjaftë të mira për zhvillimin e vreshtarisë (1.703 ha)

Livadhet përfshijnë sipërfaqen prej 2.753 ha ndërsa kullosat 5.578 ha. Sipërfaqet e pashfrytëzuara ekonomike janë pyjet dhe zabelet. Gjendja ekzistuese e pyjeve dhe e fondit të pyjeve në këtë komunë edhe pse janë ndërmarrë masa me qëllim të kultivimit, kujdesit dhe zhvillimit të pyjeve, nuk janë aq të mira edhe pse kushtet janë mjaftë të volitshme. Sipërfaqeve pyjore përbëjnë 15,561 ha prej tyre 1600 ha janë pyje të larta. Pyjet e komunës së Suharekës shtrihen në lartësi mbidetare 455 m deri 1760 m.

Këto pyje janë kryesisht pyje gjethore (lisi dhe ahu), ndërsa haloret janë mjaft të pranishme. Si lloje përcjellëse të pyjeve lisore janë: shegët, gorniçet, dardhat e egra etj., ndërsa të kaçubave pyjore: murrizi, thana, trandofillja e egër, etj. Në territorin e kësaj komune ka edhe gështenja. Sipas të dhënave të marra nga Drejtoria e Bujqësisë, Blegtorisë dhe Pylltarisë në KKS ekonomia pyjore ka dy njësi ekonomiko pyjore:

- “Biraqi” dhe
- “Kryet e Ahishtës — pyjet e Mushtishtit”.

Në “Biraqi” dominon bungu dhe ceri furs gjendet edhe qarri, pisha, mëshetekna, qershia, lajthia, thana, etj, ndërsa në “Kryet e Ahishtës - pyjet e Mushtishtit” dominon ahu pastaj pisha (të gjitha llojet), breu, mëshetekna, verri, plepi, rakiti, etj. Kushtet për zhvillimin e pylltarisë janë mjaft të volitshme. Kemi rritje të shpejt të masës drurore prej 1,70 m³ - 5,30 m³ për hektar / 1 vit.

Si pasojë e rrethanave të pasluftës këto pyje kanë pësuar dëme të shumta nga mekanizmat shtetërorë para luftës dhe nga dëmtues individual pas luftës. Megjithatë fal bonitetit të lartë të

tokës ato janë ripërtëritë vet, janë në fazën e rritjes dhe zhvillimit intensiv.

Sipas Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës, lokacioni ku është ndërtuar fabrika e rrjetave plastike, nuk ka ndonjë bimësi e cila është e veçante ose është e ruajtur si pas ligjeve të Kosovës, në zone gjinden barishte të zakonshme dhe në këtë zonë gjenden një numër i objekteve si banimi ashtu edhe industriale.

4.10 Fauna

Në ujërat e kësaj komune ekzistojnë këto lloje peshqish: krapoliq, brocak, mustak të përrojeve, dylmorë, por ka edhe ngjala. Në këto ujëra ka edhe gaforre, bretkosa dhe gjarpërinj të ujit. Nga kafshët shtëpiake kultivohen: gjellët, kuajt, derrat, beret dhe shpezët. Në zhvillimin e blegtorisë ndikojnë përveç të tjerash pjesët e imta të sipërfaqeve të punuara, dhe kullosat e pakta dhe të pa begatshme. Nëpër livadhe jetojnë stërqoka, sorra, thëllëza, shkurtëza, kukuvajka, lajmërohen edhe derrat, dhelprat, ujqi.

Sipas Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës, por edhe sipas observimeve në terren, në lokacionin e projektit nuk ka zonë të mbrojtur, nuk ka lloje të mbrojtura, të rralla, apo endemike, dhe po ashtu nuk ka një potencial për vënie nën mbrojtje të zonës apo të ndonjë lloji, andaj ky impiant për prodhimin e rrjetave nuk do të sjell ndonjë problem në lokacionin ku është i vendosur.

4.11 Peizashi

Peizashi, paraqet një nga veçoritë e rëndësishme të cilat duhet trajtuar në kuadër të vlerësimit të ndikimeve në mjedis. Edhe pse si definicion, paraqet një tërësi të elementeve natyrore, me vlerë vizuale dhe relaksuese, që ndihmon në kuptimin e ndotjes dhe emisioneve nuk paraqet efekte direkte në shëndet, megjithatë kjo duhet trajtuar dhe vlerësuar me kujdes.

Në afërsi të lokacionit ku është ndërtuar impianti, gjer me tani, nuk ka ndonjë peizazh që është shpallur i mbrojtur në bazë të legjislacionit në fuqi.

Siç është përshkruar më lartë, lokacioni i projektit për impiantin për prodhimin e rrjetave është një lokacion kryesisht i rrafshet i rrethuar me objekte tjera industriale.

4.12 Ajri

Ajri i pastër është me rëndësi vitale për shëndetin e njeriut. Mirëpo, që nga revolucioni industrial kualiteti i ajrit që e thithim ka rënë konsiderueshëm kryesisht si rezultat i aktiviteteve njerëzore. Ngritja e prodhimit industrial dhe energjetik, djegia e karburanteve fosile, si dhe rritja dramatike e trafikut kanë shtuar edhe më shumë ndotjen e ajrit, çka si rrjedhojë mund të shkaktojë probleme shëndetësore serioze.

Rreziqet e ndotjes së ajrit për shëndetin janë kryesisht të lidhura me përqendrimet e PM, veçanërisht PM2.5, që është klasifikuar si kancerogjen nga Agjencia Ndërkombëtare Kërkimore mbi Kancerin (IARC). PM2.5 depërtojnë thellë në mushkëri dhe dihet që kontribuojnë në sëmundjet e frymëmarrjes, sëmundjet kardiovaskulare dhe kancerin e mushkërive. Në sëmundjet e mushkërive kontribuon edhe dioksidi i karbonit, njëjtë si edhe ozoni, që ulin funksionimin e mushkërive dhe acarojnë astmën.

Ndotësit e ajrit klasifikohen në dy kategori. Kategoria e parë ka të bëjë me ndotësit parësorë, të cilët emetohen drejtpërdrejt përmes atmosferës. Kategoria tjetër janë ndotës dytësorë, të cilët nuk emetojnë nga burimet e tyre, por emetohen në atmosferë përmes reaksioneve me ndotësit parësorë. Ndotësit kryesorë që hasen në Evropë janë:

Përderisa, sipas Agjencisë Evropiane të Mjedisit, burimet kryesore të ndotjes janë: - Transporti (transporti rrugor, ajror, hekurudhor dhe ujor), - Tregtia/Komercializmi (institucionale dhe ekonomitë familjare), - Energjia (prodhimi dhe shpërndarja), - Industria (përdorimi i energjisë në industri, procese industriale dhe shfrytëzimin e produkteve), - Bujqësia dhe - Mbeturinat.

Duke i pasur për bëze të dhënat me lart rreth ndotjes së ajrit, theksojmë që edhe fabrikat e prodhimit të rrjetave janë burim i ndotjes, nëse nuk përmbahen rregullave për ndotje të ajrit, e sidomos munden me qene kontribuues te mëdhenj ne rritjen e PM ne atmosferë.

Mirëpo kompania GRANITI & CO SH.P.K. ka një impiant mjaft modern i cili i përmbush kriteret ligjore për të operuar.

5 PROCESIT TEKNOLOGJIK I PRODHIMIT TË RRJETAVE NGA FIRBA E XHAMI DHE PAJIMET

5.1 Objektet – pajimet e fabrikës

Impianti për prodhimin e rrjetave me fibra xhami i kompanisë GRANITI & CO SH.P.K. do të përbëhet nga këto objekte dhe pajime:

- 5.1.1 Objekti i administratës.
- 5.1.2 Pajimet për prodhimin e rrjetave plastike, kapaciteti prodhimit 48m²/min, prodhim Gjerman (ONTEC).
- 5.1.3 Salla e prodhimit
- 5.1.4 Depo

Sistemi i prodhimit të rrjetave mund të instalohet në kombinim me një makinë thurjeje ose thurjeje me fije. Kjo ofron avantazhin që një sistem unik furnizon produktin përfundimtar dhe kështu çon në një cilësi më të lartë të produktit.

Struktura e rrjetës mbetet në gjendje më të mirë, nuk ndodhin dëmtime të rrjetës. Trajtimi thjeshtohet, kohët e prodhimit zvogëlohen.

Avantazhet e Montimit në Linjë

Në një hap drejt një produkti gati për shitje.

Më pak personel.

Cilësia më e lartë e produktit, pasi lënda e parë e ndjeshme nuk ka nevojë të zhvendoset

Sistemi i veshjes paraprihet nga një makinë tekstili.

Në konfigurim shfaqet një makinë thurjeje me bazë që prodhon struktura rrjete tekstili prej fije poliesteri, fibrash qelqi, fibrash bazalti ose fibrash karboni në gjerësi të ndryshme.

Sistemet e veshjes në linjë Neuenhauser ofrojnë një ndërfaqe në kontroll për lidhje me makinat ekzistuese të tekstilit. Makinat e thurjes me bazë, si dhe ato të endjes së prodhuesve të ndryshëm, janë të pajtueshme.

Sistemi i veshjes në linjë Neuenhauser mund të kombinohet me një makinë thurjeje me endje ose me fije. Një sistem i vetëm prodhon produktin përfundimtar me cilësinë më të mirë të mundshme. Struktura e rrjetës mbetet në gjendje më të mirë, nuk ndodhin dëmtime të rrjetës. Nuk ka nevojë të trajtohen rrjeta gri me firba xhami midis hapave individualë të prodhimit. Komponentët e sistemit si zbërthyesit dhe zbërthyesit nuk janë të nevojshëm.

Kohët e prodhimit minimizohen.

Montimi jashtë linje

Sistemi i thurjes është gjithashtu i disponueshëm si një sistem i pavarur, i përshtatshëm për furnizimin e rrjetave gri për procesin e thurjes.

Sistemi në ekzekutim jashtë linje ofron avantazhin e ri-pajisjes shumë të shpejtë. Kapaciteti i thurjes së sistemit mund të shfrytëzohet deri në 100%. Brenda pak orësh është i mundur konvertimi, për shembull, nga thurja e përforcimeve të lehta të suvatimit me 60 g/m² në gjeotekstile të rënda me 4000 g/m².

Avantazhet e Montimit në Linjë


- Shpejtësi e lartë prodhimi
- Efikasitet i lartë
- Pa ndalesa të shkaktuara nga makina e paravendosur



Mbështjellësi

Sistemi thurjes shumë produktiv me dy mbështjellës të veçantë që punojnë në mënyrë alternative.

Ndërsa një njësi mbështjellëse është në funksion, njësia tjetër mbështjellëse mund të karikohet përsëri.



Njësia e lidhjes

Panelet mund të lidhen me anë të një njësie ngjitëse.


Një shirit ngjitës i veçantë fiksohet midis skajeve të rrjetës, të cilat më pas ngjiten me anë të trarëve ngrohës.



Akumuluesi i rrjetave

Një akumulator i drejtuar me bosht me një përmbajtje prej 60 m, ruan rrjetën gri të mjaftueshme për të lejuar ndërrimin e rrotullës dhe bashkimin e skajeve të rrjetës ndërsa linja vazhdon vazhdimisht.

Njësia e akumuluesit drejtohet nëpërmjet katër boshteve precize dhe funksionon me saktësi pa shtrembërim të rrjetës.



Sistemi lyerjes

Agjenti që përdoret për lyerjen e rrjetës aplikohet me një sistem të ashtuquajtur “foulard” dhe më pas shtrydhet nga një kombinim rulësh shtrydhës.

Shtrydhja është saktësisht e rregullueshme në të gjithë gjerësinë e makinës nëpërmjet 5 rulëve pneumatikë me presion.

Kjo lejon një aplikim shumë konstant të agjentit që lyhet rrjeta. Një presion në linjë deri në 7000 N/m është i disponueshëm për shtrydhjen.



Tharësja me kontakt

Tretësira që lyhet rrjeta thahet në tharësen me rula pasues me anë të dy rulave të nxehtë me një diametër prej 1000 mm secili.

Rulat janë të pajisur me një shtresë speciale anti-ngjitëse e cila parandalon ndotjen e rulave nga depozitat e lyerjes.

Vaji termik përdoret si medium transferimi i nxehtësisë për ngrohjen e rullit. Ngruhja e vajit kryhet në një kazan pranë linjës; mund të nxehtet me energji elektrike ose me gaz/vaj.



Tharësja me IR

Tharja pasuese e tretësirës të veshjes ndikohet në tharësen pasuese me infra të kuqe. Për më tepër, mund të përfundohet lidhja e kryqëzuar e veshjes plastike me tretësirën.



Mbështjellësi i rrjetave

Mbështjellësja e rrjetës në fund të linjës është projektuar si mbështjellëse rrjete në ngritje; motorët e saj janë të integruar në sistemin e përgjithshëm të kontrollit.

Një nxjerrës për rrotullat e përfunduara dhe një pajisje prerëse tërthore lejojnë një ndërrim shumë të shpejtë dhe të lehtë të rrotullës.



Sistemi i kontrollit

I gjithë sistemi shfaqet qartë në panel. Të gjithë parametrat mund të rregullohen dhe ruhen në një menaxhim recetash.

Shumica e vlerave të sistemit vizualizohen dhe mund të plotësohen për qëllime të kontrollit të cilësisë.



Specifikacioni teknik

Gjerësia e punës e rregullueshme deri në 5400 mm

Shpejtësia e prodhimit deri në 15 m/min

Diametri i rrotullës së pëlhurës gri 2 x 1200 mm

Pesha e rrotullës së pëlhurës gri 2 x 3000 kg maksimumi

Përmbajtja e magazinimit të pëlhurës deri në 60 m

Presioni i shtrydhjes deri në 7000 N/m

Tharëse me rul temperature deri në 180°C

Kapaciteti i ngrohjes së tharëses me rul 60 deri në 180 kW

Kapaciteti i ngrohjes së tharëses IR deri në 300 kW

Diametri i rrotullës së pëlhurës së përfunduar deri në 1200 mm

Pesha e rrotullës së pëlhurës së përfunduar deri në 4000 kg

Përparësitë

Për shkak të mundësive të akumulimit dhe njësisë së ngjitjes, sistemi funksionon vazhdimisht me një shkallë të lartë shfrytëzimi pa shenja në rrjeta.

Pesha e saktë dhe homogjene e rrjetës në mënyrë të qëndrueshme. rrjetë e hollë e përfunduar.




Figura 7. Skema teknologjike e linjës së prodhimit

5.2 Linja e prodhimit të rrjetave plastike

Përshkrimi i procesit teknologjik për linjën e prodhimit të rrjetave plastike.

- TË DHËNA TEKNIKE
- Paisja: SC 6540 SD / TB400x1500
- Materiali bazë: Struktura rrjete tekstili prej fije qelqi, poliesteri, bazalti ose fibra karboni
- Agjentë veshjeje: PVC plastisol, akrilate, emulsione bitumi si dhe një shumëllojshmëri kimikatesh të tjera.
- Gjerësia e punes: 1250 - 6220 mm (50" deri në 245")

- Makina është e pajisur me teknologji dhe veçori të avancuara që garantojnë prodhim të saktë dhe të qëndrueshëm.

5.3 Përshkrimi i procesit teknologjik

Procesi teknologjik i linjës së prodhimit të rrjetës nga fibra xhami

I përshtatshëm për prodhimin e rrjetave të sheshta të ngurtë, përdorni HDPE, LDPE dhe PP si lëndë të para, shtohen materiale të reja makromolekulare, si agjent antistatik dhe agjent kundër vjetërsisë, produktet neto që kanë forma dhe specifika të ndryshme mund të ekstrudohen me intensitet të caktuar tërheqës, performancë rezistente ndaj qëndrueshmërisë, rezistente ndaj korrozionit.

Rrjedha e procesit: - Lëndët e para + asistentë të tjerë → përzierje →thurje rrjete → zhytje dhe nxjerr → shtrydhja → ftohja dhe madhësia → prerja → tërheqja → shtrirja → trakt → spirale → përfundim.

Ekzistojnë procese të ndryshme nxjerrjeje, por më të zakonshmet janë: Si kjo që është paraqitur në figurën me poshtë.




Figura 8. Linja e procesit teknologjik për prodhimin e rrjetave të plastike.

Nxjerrja e rrjetës me fije xhami i referohet procesit të vazhdueshëm të transformimit të materialeve me bazë vaji siç janë polimeret. Materialet shkrihen gjatë procesit dhe formojnë një strukturë në formë tubi ose të sheshtë me hapje.

Fazat kryesore të procesit të nxjerrjes janë:

- Përzierja. Procesi me të cilin lëndët e para, ngjyruarit dhe aditivët përzihen për të marrë një shpërndarje të qëndrueshme uniforme.

- Fusion. Faza në të cilën një vidë plastifikuese transporton, barazon dhe dozon materialin ndërsa lëviz përpara në kokën e nxjerrjes.
- Formimi. Kjo është faza kryesore e procesit gjatë së cilës materiali lëviz në kokën e nxjerrjes dhe mbi një shtresë e cila i jep rrjetës formën e saj.
- Ftohja. në mënyrë që të ngurtësohet dhe të mund të trajtohet.
- Prerja. Kur preferohet një rrjetë e sheshtë, pritet brenda ose jashtë paisjes.
- Tharje dhe rrotullim. Rrjetat plastike mund të kenë një larmi të madhe formash, ngjyrash, strukturash dhe aspektesh. Ka mijëra rrjeta të ndryshme.



Figura 9. Produkti final rrjeta

Duhet potencuar që nga kjo linjë nuk pritet të ketë shkarkime në ajër ujëra dhe toke. I vetmi shqetësim mund të jetë mbeturinat që mund të krijohen në raste ku makina del jashtë sistemit digjital, gjë që do të krijohen mbeturina të rrjetës plastike.

6 PËRSHKRIMI I ALTERNATIVAVE TE ARSYESHME

Gjatë zgjedhjes së një vendi për ndërtimin e një fabrikës, është thelbësore të merren parasysh alternativa të ndryshme të arsyeshme për të siguruar zgjedhjen e vendndodhjes optimale.

Më poshtë do të japim një përshkrim të disa prej alternativave të arsyeshme që duhen marrë parasysh gjatë procesit të përzgjedhjes së lokacionit:

6.1 Zonat me industri te njëjta ekzistuese:

Përdorimi i një zone me industri ekzistuese te njëjta mund të jetë një alternativë me kosto efektive. Zona të tilla mund të kenë tashmë infrastrukturë, shërbime komunale dhe lidhje transporti, duke reduktuar kostot fillestare të konfigurimit. Ne komunën e Suharekës janë planifikuar dy zona industriale/ekonomike me planin zhvillimor komunal një është parapare në Shirokë dhe një në Duhël. Lokacioni ku është ndërtuar fabrika për prodhimin e rrjetave i përket Zonës Industriale në Shirokë, zonë kjo me industri te ndryshme.

6.2 Sipërfaqet e fushave te gjelbërta:

Vendet e fushave te gjelbërta janë tokë të pazhvilluar. Ndërsa mund të kërkojnë më shumë investime fillestare në infrastrukturë, ato ofrojnë një fushe të zbrazët për projektimin e një objekti prodhimi sipas specifikave tuaja të sakta.

6.3 Infrastruktura e transportit:

Afërsia me rrugët kryesore është thelbësore për shpërndarjen efikase të produkteve të prodhuara. Është konsideruar se lokacioni i fabrikës ka akses të mirë në rrugët kryesore, lokale dhe ne autostrade.

6.4 Ndikim mjedisor:

Vlerësimi i ndikimit mjedisor të secilit vend, duke marrë parasysh faktorë si cilësia e ajrit dhe ujit, ruajtja e habitatit dhe kërkesat e mundshme të rehabilitimit.

6.5 Zonimi dhe rregulloret:

Hetoni rregulloret lokale të zonimit dhe kërkesat e lejeve për çdo vend të mundshëm. Sigurohuni që operacionet tuaja do të jenë në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret përkatëse.

6.6 Marrëdhëniet me komunitetin:

Vlerësimi i pranueshmërinë se komunitetit ndaj një objekti për prodhim rrjeta me fibra xhami. Marrëdhëniet e mira me komunitetin janë thelbësore për të shmangur konfliktet dhe për të siguruar një proces më të qetë të lejeve.

6.7 Shërbimet komunale dhe infrastruktura:

Kontrolloni disponueshmërinë dhe kapacitetin e shërbimeve, duke përfshirë ujin, energjinë elektrike dhe sistemet e ujërave të zeza, në çdo vend. Përmirësimi ose instalimi i shërbimeve mund të jetë i shtrenjtë.

6.8 Kushtet gjeologjike dhe gjeoteknike:

Kryerja e studimeve të tokës dhe gjeoteknike për të siguruar që vendi i zgjedhur mund të mbështesë makineritë dhe strukturat e rënda të nevojshme për një fabrikë.

6.9 Kërkesa e tregut:

Analizoni kërkesën për rrjeta me fibra xhami. Një përfaqësi që është më afër tregut tuaj të synuar mund të zvogëlojë kostot e transportit dhe të rrisë konkurrencën.

5.11 Mbrojtje dhe siguri:

Është marr parasysh siguria e zonës për sa i përket rreziqeve të fatkeqësive natyrore, shkallës së krimit dhe shqetësimeve të tjera të sigurisë. Kjo është thelbësore për sigurinë e personelit dhe pajisjeve.

6.12 Potenciali i zgjerimit:

Është bere vlerësimi, nëse vendi i zgjedhur lejon zgjerimin e ardhshëm, nëse biznesi i prodhimit të rrjetave rritet. Kostoja e tokës dhe e ndërtimit: Llogaritja e kostos së blerjes së tokës dhe ndërtimit në çdo vend, duke marrë parasysh jo vetëm çmimin e blerjes, por edhe kostot e zhvillimit të infrastrukturës.

6.13 Logjistika dhe vendi i lokacionit:

Duhet të Vlerësohet se sa me efikasitet mund të rrjedhin materialet nëpër vend, duke përfshirë ruajtjen, grumbullimin dhe shpërndarjen.

6.14 Qëndrueshmëria mjedisore:

Duhet të merren parasysh praktikatat e qëndrueshme mjedisore dhe burimet e rinovueshme të energjisë kur zgjidhni një vend për të reduktuar gjurmën e karbonit të objektit.

6.15 Afërsia me fuqinë punëtore:

Duhet siguruar që ka një fuqi punëtore të disponueshme dhe të kualifikuar në afërsi të

fabrikës për të mbështetur operacionet tuaja të prodhimit konkret.

Duke marrë parasysh këto alternativa të arsyeshme dhe duke vlerësuar tërësisht secilën prej tyre, kompania Graniti & Co SH.P.K. nuk e ka pasur te vështirë të merr një vendim të informuar për vendndodhjen më të përshtatshme për fabrikën për prodhim të rrjetave. Kompania e ka parë të rëndësishme dhe ka angazhuar ekspertë të cilët kanë kryer studime gjithëpërfshirëse të fizibilitetit për të zgjedhur lokacionin që përputhet më mirë me qëllimet dhe vlerat e biznesit të kompanisë Graniti & Co SH.P.K..

Andaj duke i marrë parasysh të gjitha alternativat e më sipërme është përzgjedhur lokacioni i fabrikës nga kompania Graniti & Co SH.P.K., e cila ka qasje të mirë me autostraden “Ibrahim Rugova”, ka energjinë elektrike afër po ashtu ka edhe ujera nëntokësorë në sasi të mjaftueshme e cila ka planifikuar hapjen e pusit nëntokësor.

7 IDENTIFIKIMI DHE PËRSHKRIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS

Procesi teknologjik i aplikuar është i tillë që nuk përdor lende djegëse të dëmshme për mjedisin, impianti është automatik dhe makineritë funksionojnë nëpërmjet energjisë elektrike. Është për tu theksuar se nuk ka shkarkime të ujerave nga procesi teknologjik, pasi që procesi nuk përdoret uji, kështu që nuk kemi shkarkime të ujerave industriale gjatë procesit teknologjik dhe prodhimit të produktit përfundimtar.

7.1 Ndikimet në ajër

Ndotja e ajrit mund të rezultojë nga lëvizjet makinerive dhe automjeteve transportuese, përkatësisht ndotja nga pluhuri i ngritur nga sipërfaqet e jashtme (jashtë objektit), deri të shkarkimi i lëndës së parë, apo ngarkimi i produktit final, si dhe nga qarkullimi i makinerive të tjera, si kamion etj.

Gjatë gjithë këtyre fazave të procesit teknologjik, nga ku lirohen grimca të pluhurit, këto grimca emetohen në ajër, dhe pastaj për shkak të peshës së tyre gravitojnë në tokë, në afërsi të impiantit, ose varësisht prej erës mund të transferohen në mjedisin përreth. Në kushte të mos ndërmarrjes së masave zvogëluese, si rezultat i reliefit dhe kushteve tjera mjedisore, këto grimca mund të barten edhe në distanca më të largëta. Nivel më pak relevant i ndotjes së ajrit mund të vijë edhe nga emisionet e gazrave të automjeteve që përdoren, si kamion etj. Vlen të theksohet se i gjithë procesi i prodhimit të kompanisë Graniti & Co SH.P.K. është në objekt të mbyllur dhe ndikimet në mjedis do të jenë shumë minimale.

7.2 Ndikimet në tokë

Në dobi të minimizimit të ndikimeve në tokë, investitori do të kujdeset që gjatë gërryerjes dhe rrafshimit të tokës të punon në mënyrë profesionale ndërsa pjesë të caktuara sipas organizimit brenda parcelës do të shtrohen me zhavor dhe me beton. Njëkohësisht hapësirë e konsiderueshme e parcelës planifikohet të mbillet me pemë pas analizës së substratit.

Nga fakti se në afërsi të hapësirës ku planifikohet të ndërtohet impianti nuk ka burime të ujit të pijshëm dhe burime të ujërave nëntokësore të cilat do të mund të dëmtoheshin nga aktivitetet e këtij biznesi, mund të konkludojmë se ndikimet do të jenë minimale.

Për minimizimin e ndikimeve do të ndërmerren masat si në vijim:

- Do të përdoren makineri të cilat teknikisht do të jenë të kontrolluara, veçmas nuk do të lejohen makineri me rrjedhje vaji.
- Në zonë nuk do të lejohet shtimi, ndërrimi, vendosja e vajrave apo karburanteve
- Do të ndërtohet gropa septike, në të cilën do të grumbullohen ujërat e impiantit, për mes se cilës grope fundërrimin i grimcave në mënyrë që uji të lirohet në kanalizim.

Gjatë fazës së operimit të fabrikës, ndikime negative në tokë paraqiten nga mbeturinat e ngurta të cilat krijohen gjatë procesit të mirëmbajtjes dhe riparimeve të ndryshme; si dhe nga mbetjet e ushqimit dhe paketimet që mund të rezultojnë nga stafi / punëtorët.

7.3 Ndikimet në ujë

Shkarkimet në ujëra mund të vijnë nga:

- Në raste të derdhjes së lëndës së pare që është fluide
- Ujërat e shkarkuara nga pastrimi i hapësirës së punës e që në të mund të përmbajnë edhe materie të lëndës së pare, të cilat në rast se nuk kalojnë përmes gropave sedimentuese, mund të shkarkohen deri në lum.
- Derivatet, vajrat dhe lubrikantet të ndryshme të cilat mund të derdhen nga makineritë në përdorim;
- Pastrimi i ambientit në rast të ndonjë rrjedhjeje të padëshiruar;
- Në rastet e pastrimit të automjeteve të transportit në zonën e projektit
- Ujërat e përdorur për ambientet higjieno-sanitare të ambientit të stafit;
- Veçmas, në rast të operimeve të pakontrolluara, mund të ketë efekte negative në rrjedhjen ujore në afërsi;

Ndikimi i këtij aktiviteti në ujëra konsiston janë të për minimale sepse e gjithë hapësira punuese është e mbyllur dhe e mbuluar dhe nuk ka fare shkarkime të ujit, për veç atyre sanitare.

7.4 Ndikimet në peizazh, florë dhe faunë

Ne baze të dhënave që kemi gjetur nga raportet komunale por edhe në dalje të terrenit lokacion nuk është i evidentuar si zonë e mbrojtur e natyrës dhe as si zonë e propozuar për mbrojtje. Po ashtu kjo zonë nuk njihet si lokalitet ose habitat i llojeve të rralla bimë dhe shtazore. Megjithatë, në nivel të mikro sistemit dhe të habitatit lokal në sipërfaqe ku do të operoj impianti, nuk do të ketë kushte për zhvillim të florës dhe faunës.

7.5 Ndikimi në vendbanime dhe popullatë

Nga kjo fabrikë nuk pritet që të ketë zhvendosje të popullsisë, çrregullim të vendbanim apo çfarëdo efekti tjetër.

Nga veprimtaria e këtij aktiviteti nuk mund të ndikohen objektet për rreth nga pluhuri eventuale, si dhe nga zhurma.

Mund të thuhet se ka ndikim pozitiv në zhvillimin ekonomik të zonës dhe ndihmon në punësimin dhe mbështetjen e komunitetit lokal.

7.6 Ndikimi nga zhurma

Zhurma si rezultat i teknologjisë së prodhimit të rrjetave do të ketë një karakter lokal dhe nuk do të ketë ndikim në zonat e banuara. Zhurma do të krijohet nga makineritë dhe pajimet e procesit të prodhimit të rrjetave, automjetet transportuese dhe automjete të tjera.

Sidoqoftë, aktivitetet që zhvillohen në këtë biznes nuk pritet që të tejkalojnë nivelin e lejuar të zhurmës. Zhurma dhe vibrimet që krijohen gjatë punës nuk pritet të ndikojnë në popullatën lokale. Po ashtu gjatë zhvillimit të veprimtarisë nuk ka aktivitete që zhvillohen gjatë natës që mund të ndikonin në krijimin e zhurmave.

Sa i përket zhurmave, ato janë të ndjeshme vetëm brenda ambienteve të fabrikës dhe nuk janë problem për mjediset e jashtme dhe fqinjët.

7.7 Ndikimet në raste të aksidenteve mjedisore

Sipas natyrës së impiantit, nuk pritet përdorim i lendeve e as prodhim i produkteve të cilat

kanë rrezikshmëri të lartë për mjedisin. Aksidentet që mund të ndodhin mund të jenë të natyrave të ndryshme dhe mund të ndodhin në çdo kohë të procesit teknologjik si:

- Rrjedhjet e ndryshme të lendeve të para fluide
- Nga mekanizimi punues
- Mundësia e pëlcitjes së gypave hidraulik
- Aksidentet e mundshme në komunikacionin gjatë transportit të lëndës së parë dhe produkteve finale etj.

8 MASAT PËR ZVOGËLIMIN E NDIKIMEVE NË MJEDIS

8.1 Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ajër

Për të parandaluar dhe zvogëluar ndikimet negative në ajër gjatë fazës së operimit, përkatësisht prodhimit të rrjetave, për parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimeve në ajër duhet të ndërmerren këto masa:

- Pluhuri i cili lirohet gjatë procesit teknologjik të prodhimit duhet të mënjanohet apo zvogëlohet deri në kufijtë minimal dhe pa ndikime në mjedis dhe shëndet.
- Të bëhet kontrolli i rregullt teknik i automjeteve transportuese
- Vazhdimisht të spërkatën me ujë platoja operationale, aty ku ka potencial për pluhur, sidomos gjatë kohës me erëra dhe me temperatura të larta.

8.2 Masat për zvogëlimin e ndikimeve në tokë

Për të parandaluar dhe zvogëluar ndikimet në tokë, gjatë fazës së operimit, prodhimit, duhet të ndërmerren masat si në vijim:

- Të gjitha pajimet, stabilimentet e nevojshme për procesin e prodhimit të mirëmbahen dhe kontrollohen rregullisht
- Të bëhet betonimi i platosë ku bëhet vendosja e pajimeve, gjeneratori, depot e vajrave e lubrifikantëve dhe të pajimeve tjera, si mjete sekondare të punës
- Ndërrimi i vajrave të makinave të bëhet në vende të posaçme, të betonuara dhe të izoluara,
- Mbeturinat e ngurta duhet të grumbullohen dhe klasifikohen sipas llojit dhe

përbërjes. Ato që nuk mund të ripërdoren apo të shiten duhet të dërgohen në deponime regjionale të mbeturinave

- Mbeturinat komunale duhet të vendosen në kontejner adekuat të mbuluar me kapak, dhe duhet të bëhet marrëveshje me kompaninë komunale për mbledhje të mbeturinave.
- Vajrat e përdorura duhet të vendosen në enë të vecant dhe t'u shiten kompanive të licencuara për mbledhjen e vajrave të përdorura.

8.3 Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ujë

Për parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimeve negative në ujëra, duhet ndërmarrë këto masa:

- Në lokalitetin e fabrikës duhet të behët sistemi për bartjen dhe grumbullimin e ujërave të ndotura të krijuara nga procesi i prodhimit, nga larja e automjeteve transportuese apo automjeteve të tjera, si dhe të ujërave të reshurave atmosferike.
- Duhet rregulluar sistemin gypor për bartjen e ujërave të cilat duhet të barten në puse sedimentuese për trajtimin e ujërave, përkatësisht për sedimentimin e grimcave të ngurta
- Kolektorët duhet të rregullohen ashtu që e tërë sasia e ujërave industriale si dhe të reshurave nga platotë dhe nga tërë sipërfaqet funksionale të grumbullohen dhe të orientohen në pusët sedimentuese, e pastaj në separator.
- Duhet të ndërtohen tri puse sedimentuese në mënyrë që të sedimentohen grimcat e ngurta
- Duhet të ndërtohet separatori i vajrave në mënyrë që ujërat të pastrohen nga vajrat që kanë rrjedhur nga sipërfaqet operacionale, automjetet etj. Separatori duhet të ndërtohet ashtu që rregullisht të mund të kontrollohet dhe të merren mostrat,
- Pusët sedimentuese dhe separatori duhet rregullisht të pastrohen nga mbeturinat. Mbeturinat duhet të dërgohen në deponi regjionale.
- Ujërat e zeza duhet të trajtohen përmes gropës septike. Pastrimi i gropës septike duhet të bëhet nga kompanitë publike për ujësjellës dhe kanalizim.
- Kompania duhet që të matjen e cilësisë së ujërave të shkarkuara, dhe se vlerat e fituara duhet të krahasohen me vlerat e caktuara me udhëzimin administrativ 13/2008. Vlerat e cilësisë së ujit të shkarkuar nuk guxojnë të jenë më të larta se ato të përkufizuara në udhëzim administrativ.

8.4 Masat për mbrojtjen nga Zhurma

Kompania duhet të bëjë matjet e zhurmës në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi. Matjet duhet të bëhen afër vendbanimeve, në mënyrë që të vërehen ndikimet në vendbanim. Në rast se rezultatet e matjeve tregojnë vlera më të larta sesa ato të lejuarat, atëherë kompania duhet të ndër marrë masat e duhura.

Varësisht prej procesit të punës, në mjediset ku parashihet zhurmë e madhe, punëtorët duhet të bartin pajisje për mbrojtje nga zhurma.

8.5 Masat për mbrojtje nga rreziqet dhe aksidentet

Për të parandaluar pasojat e mundshme, kompania duhet të zhvilloj plan të menaxhimit të rrezikut nga aksidentet mjedisore. Gjithashtu duhet të përgatit një plan për parandalimin e zjarrit, por edhe plan për menaxhimin e situatave në raste të zjarrit.

Si masë parandaluese, i tërë lokacioni duhet të jetë i rrethuar, mbrojtur nga ndikimet fizike të jashtme. Duhet të vendosen rrethoja adekuate. Duhet të merren masat e sigurisë për evitimin e derdhjes së vajrave apo derivateve.

Duhet që të ndërmerren të gjitha masat e sigurisë, konform ligjit për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të të punësuarve dhe të mjedisit të punës.

9 PROGRAMI I MONITORIMIT

Duke e pasur parasysh se ky aktivitet nuk parasheh përdorim të lëndëve djegëse, nuk parasheh procese të djegies, shkrirjes, apo furra me temperatura të mëdha, si dhe nuk parasheh shkarkime të ujërave të zeza nga proceset teknologjike, nuk konsiderohet e detyrueshme monitorimi permanent i tregueseve mjedisor. Megjithatë, rekomandohet që në mënyrë periodike, investitori të monitorojë këto tregues të trysnisë në mjedis:

- Për ajrin duhet të monitoroj Lëndën e Ngurtë Pezull (LNP) dhe zhurmat në ambientin e punës (dB).
- Për ujin: lënda e ngurtë pezull, përmbajtja e CaCO_3 .
- Për token, nuk aplikohen detyrime monitorimi

10 RAPORTIMI

Raportimi do të kryhet nga personi përgjegjës i autorizuar nga menaxhmenti, gjegjësisht nga ekspertët e kompanisë. Në raport do të përfshihen të dhënat për monitorimin siç do të jetë kërkuar në pëlqimin mjedisor, përkatësisht lejen mjedisore.

11 MASAT REHABILITUESE PAS PËRFUNDIMIT TË AKTIVITETIT

Pas përfundimit të aktivitetit prodhues, pajimet e impiantit duhet të çmontohen dhe të largohen nga ky lokalitet. Bazamentet si dhe platotë nga betoni duhet të shkatërrohen, imtësohen dhe të dërgohen në deponinë regjionale. Substratet e krijuara gjatë procesit të prodhimit, përmbajnë rërë, zhavorr, çimento beton etj. Ato duhet të largohen, dhe me një trashësi rreth 0.5 m struktura përfundimtare duhet të jetë e mbuluar me dheun, e cila është adekuate me dheun e mëparshëm dhe ku do ti përshtatet substratit të tokës.

Rikultivimi i këtyre sipërfaqeve të dëmtuara apo të degraduar nga ndryshimi i destinimit do të përfshij rivitalizimin në tërësi të hapësirës së dëmtuar nga veprimtaria ekzistuese. Zgjedhja e rikultivimit dmth modelit, varet edhe nga qëllimi i përdorimit të tokës, siç do të jetë e paraparë me planet komunale..

12 PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Sipas analizës së bërë mbi ndikimin e objektit dhe linjave të prodhimit, si dhe në bazë të vlerësimit të projektit të propozuar, për lokacionin e analizuar sipas autorit të raportit nuk rrezikon mjedisin sepse janë realizuar shumë nga parakushtet e nevojshme për mbrojtjen adekuate të mjedisit, por megjithatë duhet të parashihet që në rast se vije deri te ndotja duhet të ndermirren masat për parandalimin apo së paku zvogëlimin e ndikimeve negative që shpijnë deri të rrezikimi i mjedisit jetësor.

Nga sa u tha më sipër nxjerrim si përfundim se:

- ✓ Objekti i ndërtuar në një zonë të përshtatshme për këtë lloj aktiviteti, i cili do të ndikojë pozitivisht edhe në zhvillimin ekonomik të zonës;
- ✓ Teknologjia që do të zbatohet është e përshtatshme dhe funksionale;
- ✓ Në veçanti, nga analiza e kryer në tërësi e këtij aktiviteti, nuk konstatohen ndikime të veçanta mjedisore si në florë, faunë, tokë, ujë dhe ajër.

Me qëllim të zvogëlimit të mëtejshme të ndikimeve potenciale negative në mjedis, rekomandohet ndërmarrja e masave shtesë të cilat bëjnë pjesë në domenin e menaxhimit të rrezikut në objektin për rrethanat e jashtëzakonshme dhe të rregullta. Nga vlerësimi në përgjithësi i këtij aktiviteti konstatohet se:

- ✓ Nuk vërehen ndikime negative të aktivitetit;
- ✓ Është lehtësisht i zbatueshëm;
- ✓ Teknologjia e zbatuar është bashkëkohore;
- ✓ Makineritë dhe pajisjet janë të thjeshta,
- ✓ Zona ku zhvillohet ky aktivitet është zone me bazë zhavorri me një shtresë humusore jo më të trashë se 5-10cm si rezultat i bartjes se limit ndër vite.

Gjate funksionimit të këtij aktiviteti janë marrë të gjitha masat për eliminimin e ndikimeve negative në mjedisin përreth. Për këtë qëllim ky aktivitet nuk pritet të ketë ndikim mjedisor pasi:

- ✓ Nuk shkakton ndotje të tokës me shkarkime të ndryshme të lëngëta apo të ngurta;
- ✓ Nuk ka shkarkime në ajër të gazrave apo tymrave jashtë normave të lejuara;
- ✓ Zhurmat në mjediset e punës pritet të jenë brenda normës sanitare të lejuar dhe për pasojë as zhurmat në mjediset e jashtme nuk pritet të kenë ndikim në popullatën përreth;
- ✓ Ka vlera normale të temperaturës dhe lagështisë në mjediset e punës;
- ✓ Janë marrë të gjitha masat për mbrojtjen në punë dhe masat për evitimin e rrezikut të zjarrit.
- ✓ Është bërë rrethimi i fabrikës.
- ✓ Të bëhet spërkatja e sipërfaqeve të materialit dhe inerteve me pluhur si dhe rrugëve komunikuese, që mos të ketë ngritje të pluhurit në ajër.
- ✓ Të kryhet larja apo pastrimi i gomave të automjeteve para daljes së tyre në rrugët e asfaltuara të zonës.
- ✓ Të grumbullohen mbeturinat të ndahen sipas llojit (letra, plastik, stiropor, blloka, tulla, etj.) të vendosen në kontejner i cili duhet të jetë në hapsirat e fabrikës dhe t'i dorëzohen mbeturinat kompanive të licencuara për menaxhim të tyre.
- ✓ Gjate ditës nga ora 07:00 deri me 19:00 niveli i zhurmës të mos kalojë normat lejuara ashtu siç parashihet me ligje, ndërsa pas orës 19:00 nuk do të ketë punime.
- ✓ Të vendosen shenja sensibilizues për punonjësit për një mjedis të pastër.
- ✓ Të zbatohen masat për eficient të energjisë, muret e jashtme të izolojnë me stiropor 8 cm N3, dritaret të jenë termopan, llampa kursyese të energjisë, llampa solare dhe automatike.
- ✓ Fasada të jetë cilësore për të krijuar një pamje estetike integruar me elemente të zonës.
- ✓ Të respektohet përqindja e krijimit të hapësirës gjelbëruese sipas kushteve ndërtimore dhe

situacionit të projektit të ndërtimit.

- ✓ Të mbjellën bimë, fidane shumëvjeçare dekorative autoktone të qëndrueshme. Oazat për gjelbërim të mbillet me bari, (bari Slloven), shkurre, fidane shumëvjeçare, Bli gjethegjerrë (Tilia), dru Rrapi (Platanus orientalis), pisha të varietetit Nordman, Smarak, etj.
- ✓ Investitori do të vendosen tre kontejner të madhësisë 1.1 m3 për grumbullim të mbeturinave.
- ✓ Përreth perimetrit të fabrikës duhet të ndërtohen kanale drenazhuese për mbledhjen e ujërave atmosferike.
- ✓ Përreth zonës së mbrojtur të ujërave nuk duhet të kryhen aktivitete ndërtimore.
- ✓ Investitori të respektojë detyrimet e vendosura në vendimin e VNM-së që do të miratohet nga institucionet.
- ✓ Investitori të respektojë të gjitha masat e përcaktuara në këtë raport të VNM-së.
- ✓ Të zbatohen masat për mbrojtjen e ujërave nëntokësore sipas raportit.
- ✓ Investitori të jetë në dijeni të kuadrit ligjor për mjedisin dhe ndryshimeve të tij.
- ✓ Investitori të respektojë dhe zbatojë kushtet teknike në objektet e kompleksit për mbrojtjen nga zjarri dhe të krijojë infrastrukturën e nevojshme për zjarrfikësit.

Përfundim: Ndikimi në Mjedis gjatë ndërtimit të Objektit Industrial dhe pas vendosjes së linjave të prodhimit, me lokacionin në Komunën e Suharekës që do të jetë në njësinë e kadastrave kadastrale në ngastrat kadastrale me nr: P-72116046 – 02785-15 dhe P-72116046- 02785-16, nr. i lëndës së Çertifikates 1844/2025, vendi i quajtur Shirokë në zonën industriale të Suharekës, Zona kadastrale Suhareke, komuna e Suharekës do të jetë në nivelin e vlerave të standardeve të caktuara me ligjet dhe aktet nënligjore të aplikueshme.

Ndikimet në ajër, tokë, ujë, zhurmë si dhe ndikimet tjera mund të kontrollohen. Këto ndikime do të monitorohen dhe nëse evidentohen probleme mjedisore do të raportohet në Institucionet Përkatëse. Pas punimit të këtij raporti të VNM-së, mund të konkludohet se Objekti Industrial me linja të prodhimit nuk ka potencial të rrezikimit të shëndetit të njerëzve, gjithashtu ndikimet në ajër, tokë, ujë dhe peizazh, pas identifikimit dhe zbatimit të gjitha masave mbrojtëse të rekomanduara në këtë raport të VNM-së ato mund të zvogëlohen në nivel të lakmueshëm, edhe të synohet eliminimi i tërësisht në fazën e rehabilitimit të hapësirave të degraduara gjatë ndërtimit dhe realizimit të projektit.

Mendojmë se këto të dhëna janë të mjaftueshme organit kompetent të ministrisë për dhënien e mendimit pozitiv për Pëlqim Mjedisor për Fabrikën e Prodhimit të Rrjetave Plastike në fjalë.

13 ANALIZA KOST – BENEFITE E PROJEKTIT NË FORMË TABELARE

Tabela 3. Tabela e kostos

TABELA E KOST – BENEFITIT TE INVESTIMIT NE IMPIANTIN E PRODHIMIT TË RRJETAVE PLASTIKE		
Nr.	Emri	Çmimi (€)
1.	Komplet fabrika e prodhimit, instalimet, shpenzime tjera për vënien në punë të fabrikës	1,999,999.00
Shuma totali investive:		1,999,999.00

Graniti & Co SH.P.K

Islam Balaj

Nënshkrimi dhe Vula

Besim REXHEPAJ

I Licencuar për VNM, Nr. i Licencës: 14/19/24

Nënshkrimi

14 LITERATURA E PERDORUR

Lista e bibliografisë (referencave) së burimeve të përdorura për përshkrimet dhe Vlerësimet e përfshira në raport.

- Te dhënat nga Investitori,
- Projekti Konceptual,
- Harta zonale komuna Suharekë
- Pzhk – Suharekë,
- Kërko dhe paraqit - KGP (rks-gov.net)
- OpenStreetMap
- LIGJI NR. 08/L-181 PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS (rks-gov.net)